



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:064322

Datë: 16.02.2024

Numri i dokumentit: 05341472

**C.nr.908/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.Z. nga Peja, të cilin me autorizim e përfaqëson H.K. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Universiteti “U.H.”, me seli në Prizren, për shkak të: anulimi i vendimit Nr.308-01/107, të datës 21.02.2023, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës, me datë 16.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Hedhet Poshtë padia e paditësit B.Z. nga Peja, me numër C.nr.908/2023, kundër të paditurës Universiteti “U.H.”, me seli në Prizren, për shkak të: anulimi i vendimit Nr.308-01/107, të datës 21.02.2023.

**A r s y e t i m**

Paditësi B.Z. nga Peja, përmes të autorizuarit të tij H.K. avokat nga Prishtina, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi kundër të paditurës Universiteti “U.H.”, me seli në Prizren, për shkak të anulimi i vendimit Nr.308-01/107, të datës 21.02.2023.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprak të padisë, konstatoi faktin se padia e paraqitur është jo e plotë, ngase nuk është sqaruar saktë nga ana e paditësit se çka është objekti i kontestit në këtë çështje kontestimore, përkatësisht nuk është përcaktuar nga paditësi se cila është kërkesëpadia e tij. Paditësi në padinë e tij ka paraqitur kronologjinë e shkresave të përmbledhura që nga shpallja e konkursit e deri te padia. Po ashtu paditësi padinë dhe provat materiale nuk i ka paraqitur në kopje të mjaftueshme edhe për palën e paditur, ashtu si kërkohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Pas kësaj, gjykata me aktvendimin C.nr.908/2023, të datës 08.11.2023, ia ka kthyer në plotësim padinë paditësit, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësoj-precizoj padinë duke përcaktuar qartë objektin e kontestit, si dhe të përcaktohet kërkesa në pikëpamje të çështjes kryesore, e po ashtu gjykatës të ia paraqet padinë dhe provat materiale në kopje të mjaftueshme për palën e paditur, duke e paralajmëruar për pasojat ligjore të mos veprimit sipas dispozitivit të aktvendimi.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 15.02.2024, ka bërë plotësimin e padisë, duke theksuar se kërkon anulimin e vendimit të të paditurës me numër 308-01/107, të datës 21.02.2023, mirëpo gjykatës nuk ia ka paraqitur kopjen e padisë dhe provat materiale në kopje të mjaftueshme për palën e paditur.

Gjykata vlerëson se paditësi edhe pse e ka dorëzuar parashtrësën e lartcekur, i njëjti përsëri nuk ka vepruar bazuar në aktvendimin e kësaj gjykate të datës 08.11.2023, nuk e ka bërë plotësimin e padisë që gjykatës të ia paraqet padinë dhe provat materiale në kopje të mjaftueshme për palën e paditur, konkretisht nuk ka ndërmarrë veprimet që ka qenë i detyruar sipas atij aktvendimi.

Me nenin 102 par. 4 të LPK-së është paraparë se *“Në qoftë se parashtrësat apo dokumentet që i bashkëngjiten nuk janë dorëzuar në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, gjykata do ta ftojë parashtruesin që brenda afatit të caktuar t’i paraqes ato. Po që se parashtruesi nuk vepron sipas këtij urdhri, gjykata do ta hedhë poshtë parashtrësën e tij.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë plotësimin e padisë, përkatësisht gjykatës nuk i ka dorëzuar, padinë dhe provat materiale në kopje të mjaftueshme për palën e paditur, duke u bazuar në nenin 102 par. 4 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2023:064322, 16.02.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Taulant Rexhëbeqaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.